

MEMORANDUM BASHKEPUNIMI

ndërmjet

**INSPEKTORATIT TE LARTE TE DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TE
PASURIVE**

dhe

**DREJTORISE SE PERGJITHSHME TE PARANDALIMIT DHE
PASTRIMIT TE PARAVE TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive në mbështetje të ligjit nr.9049, date 10.4.2003 "Per deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" nenit 17, pika "ç" bashkëpunon me organet e auditimit dhe me strukturat e tjera përgjegjëse për luftën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik.

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave në bazë të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", ndryshuar me ligjin nr.9084, datë 19.6.2003, nenit 15, bashkëpunon me organizatat dhe institucionet qendrore e ndërkombëtare dhe shkëmben të dhëna me qëllim identifikimin, zbulimin, sekuestrimin e mjeteve që lidhen me pastrimin e parave.

Përsa më sipër, palët bien dakort të respektojnë qëllimin e këtij Memorandumi Bashkëpunimi si më poshtë:

Neni 1 Qëllimi

- Realizimi i bashkëpunimit të ndërsjelltë ndërmjet dy palëve në përshpejtimin e procedurave ligjore në rastet e verifikimit të llogarive bankare, asetëve dhe pasurive jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Bashkërendimi i veprimeve të ILDKP dhe DPPPP që vepron si Njësi e Inteligjencës Financiare (NIF), ndërmjet NIF homologe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në bazë të ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave".
- Koordinimi dhe mbledhja e të dhënave personale që lidhen me llogaritë bankare, asetet, pasuritë dhe detyrimet financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë jashtë territorit të

Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet bashkëpunimit me njësitë homologe nga ana e DPPP, në bazë të kërkesës me shkrim të dërguar nga ILDKP.

- Koordinimi dhe mbledhja e të dhënave personale që lidhen me llogaritë bankare, asetet dhe pasuritë e deklaruara ose jo në ILDKP nga zyrtarët-subjekte të ligjit nr.9049, nr.9367, nr.8610 dhe nr.9084 për nevoja të punës së palëve në këtë Memorandum, në zbatim të legjislacionit shqiptar, rekomandimeve të Direktivës së tretë të Parlamentit Europian si dhe Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF).

Neni 2

Objekti

- Palët do të angazhohen për bashkëpunim konkret në realizim të qëllimit sipas nenit 1 të këtij Memorandumi. Palët do të bashkëpunojnë në mbledhjen, zhvillimin dhe analizimin e informacionit që do të shkëmbejnë në lidhje me fshehjen e pasurisë, korrupsionin, krimin ekonomik, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Bazuar në kërkesat reciproke, palët përkatësisht do të shkëmbejnë çdo informacion të disponueshëm që mund të ketë të bëjë me investigimin e njëjës ose të dy palëve për fshehjen e pasurisë, korrupsionin, krimin ekonomik, pastrimin e parave dhe financimin kundër terrorizmit apo aktiviteteve kriminale që lidhen me to, me personat, kompanitë dhe/ose subjekte të tjera të përfshira. Kërkesa për informacion do të arsyetohet shkurtimisht. Pala kërkuese duhet t'i paraqesë pales tjetër qëllimin për të cilin do të përdoret informacioni i kërkuar.
- Informacioni i përfutur është konfidencial dhe do të administrohet sipas të gjitha rregullave të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.
- Palët nuk do të lejojnë përdorimin apo shpërndarjen e ndonjë informacioni ose dokumenti, pjesë e këtij Memorandumi, për qëllime të tjera përveç atyre që janë përcaktuar në të, pa miratimin paraprak me shkrim të Pales dhënëse.

Neni 3

Komunikimi

Palët do të caktojnë person kontakti që do të jenë përgjegjës për zbatimin e Memorandumit. Në rastet e shmangies nga procedurat e përcaktuara në këtë Memorandum, palët do të merren vesh për procedura të pranueshme komunikimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Neni 4
Ndryshime**

Memorandumi mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjelltë me shkrim të palëve.

**Neni 5
Përfundimi i Memorandumit**

Memorandumi mund të përfundojë në çdo kohë. Përfundimi do të hyjë në fuqi me marrjen e njoftimit me shkrim nga Pala tjetër. Deri në përfundimin e këtij Memorandumi, palët do t'u përmbahen termave dhe kushteve që rrjedhin nga ky Memorandum, përsa i përket informacionit dhe dokumentave të shkëmbyera përpara dates së përfundimit të tij.

**Neni 6
Hyrja në fuqi**

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj nga përfaqësuesit e palëve. Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe dy të tjera në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

**Për Inspektoratin e Lartë të
Deklarimit dhe Kontrollit
të Pasurive**

**Për Drejtorinë e Përgjithshme të
Parandalimit të Pastrimit
të Parave**

**INSPEKTOR I PERGJITHSHEM
FATMIRA LASKA**

**DREJTOR I PERGJITHSHEM
ADRIATIK ISLAMAJ**



Tirane, më 23.4.2006